**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**Bashkimi i Operatoreve Ekonomike**
OSMANI/G&BAJRAMI-N SHPK
Perfaqesuesi me Prokure
**DREJTUESI LIGJOR OSMANI/G**
**MUSTAFA OSMANI**

**Bashkia e Qytetit Gramsh**

**K R Y E T A R I**
**DRITAN BICI**

KONTRATE SIPERMARRJE

Nr. 1601 date,02.07.2014

Ne tenderin e zhvilluar me date 13.06.2014 me objekt:"Sistemim dhe gjelberim te territorit prane fushes se vjeter te sportit",me Vendim te Komisionit te Vleresimit te Ofertave nr.1,date 13.06.2014 u shpall fitues bashkimi i operatoreve ekonomike "Osmani/G&Bajrami-N"shpk.

E lidhur sot me date 02.07.2014,midis Bashkise Gramsh me cilesine e investitorit e perfaqesuar nga Kryetari Bashkise z.Dritan Bici dhe sipermarresve, bashkimit te operatoreve ekonomike "Osmani/G&Bajrami-N"shpk,me NIPT-e respektive,J76314808M dhe K02727202O,me perfaqesues ligjor z.Mustafa Osmani per "Osmani/G"dhe z.Nazif Bajrami per "Bajrami-N"shpk,te perfaqesuar me prokure nga z.Mustafa Osmani,per realizimin e punimeve ne objektin:"Sistemim dhe gjelberim te territorit prane fushes se vjeter te sportit"

**BAZA LIGJORE Neni 850 I Kodit Civil**

**Neni I(Palet)**

Bashkia Gramsh ne cilesine e investitorit(porositesi)
Bashkimi i operatoreve ekonomike "Osmani/G&Bajrami-N"shpk.ne cilesine e sipermarresit.

**Neni II(Objekti i Kontrates)**

"Sistemim dhe gjelberim te territorit prane fushes se vjeter te sportit""ne qytetin e Gramshit.

**Neni III(Cmimi i punimeve)**

Vlera e punimeve te sipermarrjes qe do te kryhet ne kete objekt eshte **1 566 499**(nje milion e peseqinde e gjashtedhjete e gjashte mije e katerqinde e nentedhjete e nente)leke me TVSH.

Per vitin 2014 do te financohen nga buxheti i shtetit vlera **1 495 740**(nje milion katerqinde e nentedhjete e pese mije e shtateqinde e dyzete )leke
Shuma prej **70 759**(shtatedhjete mije e shtateqinde e pesedhjete e nente)leke do te financohet per vitin 2015

**Neni IV(Afatet)**

Afati i kryerjes se punimeve do te jete 45( dyzete e pese )dite

Punimet fillojne 5 dite pas lidhjes se kontrates
Punimet mbarojne ne daten duke llogaritur nga data e fillimit te punimeve per 45 dite qe eshte afati i punimeve..

**Neni V(Drejtuesi I Punimeve)**

Drejtuesi i punimeve ne objekt do te jete **Ing.**______________________ me nr.License___________________________________.

**Neni VI(Detyrimet e paleve)**

Detyrimet e paleve jane ato qe lindin ne kuptim te nenit 420 te Kodit Civil

a)Detyrimet kontraktuale jane ato te percaktuara ne Dokumentat Standarte te Tenderit me objekt" Sistemim,asfaltim dhe gjelberim rreth Pallatit te Kultures"saktesishte ne .
Formular Kontrate
Formularin për Ofertë, të paraqitur nga Ofertuesi
Kërkesat e pergjithshme te Pranimit/Kualifikimit
Programin Përfundimtar dhe Specifikimet Teknike
Preventivin e Kostove
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
Kushtet e Veçanta të Kontratës
Njoftimin e Fituesit nga Autoriteti Kontraktor
Formularin e Sigurimit të Kontratës

b).Detyrimet ligjore(Detyrimet qe lindin per zbatimin e aktet normative ne fushen e prokurimeve,kontrollit dhe disiplnimit te punimeve,urbanistikes etj).

Neni VII(Penalitet)

Penalitet do te jene ato te percaktuara ne Kushtet e Pergjithshme dhe Kushtet e Vecanta te Kontrates.( dokumentat standarte te tenderit)

**Neni VIII (Te vecanta)**

I gjithe dokumentacioni i pergatitur per zhvillimin e procedures se tenderit te kerkese per propozim me objektin e mesiperm eshte pjese perberse e kesaj kontrate me sipermarrje.

OSMANI SH.P.K GRAMSH NDERTIM MONTIM

KOZ... ELBASAN IMP-EXP "BAJRAMI N" SH.P.K. NDERTIM - MONTIM

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA GRAMSH

120

Ne cdo moment investitori ruan te drejten e ndonje ndryshimi te mundshem ne project,gjithmone per interes public,pa cenuar anen funksionale,teknike si dhe ate financiare te objektit.

**Neni IX(Garancia e difekteve)**

Garancia e difekteve eshte shuma prej 5 (pese)% e mbajtur nga situacionet periodike e pafinancuar per nje periudhe 1-vjecare nga data e hartimit te Certifikates se Marrjes ne Dorezim te Punimeve.
Difekte qe do te riparohen nga sipermarresi jane ato qe do te cmohen nga investitori,se kane ardhur si pasoje e punes pa cilesi dhe mosrespektimi i standarteve,normave dhe kritereve teknike ne fuqi nga ana e sipermarresit.Keto difekte do te riparohen Brenda afateve qe do te percaktoje investitori dhe teknologjia e riparimit te difektit.

**Neni X(Komunikimi)**
Komunikimi investitor-sipermarres ne cdo rast do te behet vetem me shkrim.

**Neni XI(Zgjidhja e mosmarreveshjeve)**

Mosmarreveshjet zgjidhen ne Gjykaten e rrethit Gjyqesor Elbasan.

Neni XII(Dokumenta bashkelidhur)

Kjo kontrate ka fuqi ligjore vetem kur bashkelidhur saj jane Formulari i Kontrtaes firmosur rregullishte nga palet.Formulari i sigurimit te Kontrates ne masen **156 650**(njeqinde e pesedhjete e gjashte mije e gjashteqinde e pesedhjete) leke,urdheri xhirimi ose mandate pagesa per sigurimin e KONTRATES.
Kjo kontrate u hartua ne pese kopje me fuqi te barabarta ligjore dhe ne perfundim kontrata pasi lexohet,kuptohet dhe gjendet e pranueshme nga palet ,me vullnet te lire firmoset si me poshte

Konc.Daktil.Q.Paja
Dosja nr.________
Afati ________

U pa nga Drejt.Jurid.Sherb.Mbesht.
**Elidjan KOÇI**

SIPERMARRESI
Bashkimi i Operatoreve Ekonomike
OSMANI /G&BAJRAMI-NSHPK

**OSMANI/G SHPK MUSTAFA OSMANI**

**BAJRAMI-N SHPK NAZIF BAJRAMI**

**INVESTITORI**
**BASHKIA GRAMSH**

**K R Y E T A R I**

**DRITAN BICI**

121